

Statistikat e Transportit Hekurudhor

Tremujori I, 2025


Tiranë, më 29 Prill 2025: Gjatësia e rrjetit hekurudhor në shfrytëzim në vend është 253 km. Në shfrytëzim janë linjat hekurudhore: Kufi - Gjorm 93 km, Durrës - Elbasan 76 km, Rogozhinë – Fier 49 km dhe Fier – Vlorë 35 km. Transporti hekurudhor i mallrave është në distancë 0 - 49 km.

Statistikat e Transportit hekurudhor, për tremujorin e parë 2025, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuara nëpërmjet rrugëve hekurudhore është 138,5 mijë ton, duke shënuar rritje me 9,2 %, në krahasim me tremujorin e parë 2024.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në mijë ton-km rezultoi 4.637 nga 4.399 mijë ton-km në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke u rritur me 5,4 %.

Fig 1: Transporti hekurudhor i mallrave, 000/ton-km



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Për publikim 29/04/2025

"Qymyri dhe linjiti, nafta bruto dhe gazi natyror" sipas klasifikimit NST 2007 (Nomenclatura e Statistikave të Transportit), zënë 89,8 % të mallrave të transportuar me hekurudhë , "Lëndë të para të ricikluara; mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturina të tjera" 9,9 % dhe "Metalet bazë; produktet metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve" zënë 0,3 % (tab.1).


Tab 1: Mallra të transportuara me hekurudhë sipas NST 2007, në 000/ton

Nr	Kategoritë e mallrave të transportuara në hekurudhë	Mallra gjithsej në 000/ton	
		Tr I-2025	%
Gjithsej		138,5	100,0
1	Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror	124,4	89,8
2	Metale bazë; produkte metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve	0,4	0,3
3	Lëndë të para të ricikluara;Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera	13,7	9,9

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Në tremujorin e parë 2025, kanë përdorur transportin hekurudhor si mjet udhëtimi 577 pasagjerë, duke shënuar ulje me 33,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Fig 2: Numri i pasagjerëve në transportin hekurudhor, 000 pasagjerë/km



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve që përdorin një automjet hekurudhor në një rrjet të caktuar hekurudhor.

Gjatësia e shinave: Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.

Pasagjerë të transportuar me hekurudhë: Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përfshirë personat e destinuar për shërbime në tren.

Ton-kilometër (TKM) - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.

Mallra të transportuara me hekurudhë - Do të quhet çdo lëvizje malli që kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë konteinerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

Tren-kilometër - janë distancat në kilometra të përshtuara nga trenat.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i parët, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i parët, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet parë mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>